



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06/IA026

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 mars 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatës Kai Ambos

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Ben Emerson

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit
të Specializuar:**

Aleks Uajting

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtësit të Viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagendra

Mbrojtëses së Viktimave me Kërkesa të Refuzuara:

Jelena Cakiq

Mbrojtjes së Parashtruesit 24/06:

Gregori Taunsend

Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave:

Shefes së Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), bazuar në nenet 33(1)(c) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullat 113(6) dhe 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullat 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur për Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave në përputhje me nenin 22(6) të Ligjit nr. 05/L-053¹ (“Parashtrimet”), Apelin e Mbrojtësit të Viktimave ndaj Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave² dhe Apelin e Viktimës 24/06 kundër Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në përputhje me Rregullën 113(6) të Rregullores me Shtojcat 1 deri 7 Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*³ (bashkërisht “Apelet”).

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 dhjetor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin e Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave (“Vendimi i Apeluar”), me anë të të cilit ndër të tjera ai refuzoi kërkesat e disa individëve për të marrë pjesë si viktimë në procesin gjyqësor aktual.⁴
2. Më 13 shkurt 2023, mbrojtësi i parashtruesit 24/06 të cilit iu refuzua kërkesa, paraqiti një apel. Më 28 shkurt dhe 2 mars 2023, mbrojtësja e 19 parashtruesve kërkesat e të cilëve u refuzuan, paraqiti parashtrim dhe apel tjetër.

¹ IA026/F00008, Parashtrime të Mbrojtësit të Viktimave në përputhje me Nenin 22(6) të Ligjit Nr. 05/L-053, 28 shkurt 2023 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*). Një variant i këtyre parashtrimeve, i redaktuar për publikun, u dorëzua më datë 1 mars 2023. Shih IA026/F00008/RED.

² IA026/F00009, Apel i Mbrojtësit të Viktimave ndaj Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 2 mars 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*). Një variant i këtij apeli, i redaktuar për publikun, u dorëzua më 9 mars 2023. Shih IA026/F00009/RED.

³ IA026/F00006, Apel i Viktimës 24/06 ndaj Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në përputhje me Rregullën 113(6) të Rregullores me Shtojcat 1 deri 7 Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 13 shkurt 2023 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*). Një variant i këtij apeli, i redaktuar për publikun, u dorëzua po atë ditë. Shih IA026/F00006/RED.

⁴ F01152, Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 12 dhjetor 2022 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*), paragrafi 73(b). Një variant i vendimit të apeluar, i redaktuar për publikun, u dorëzua po atë ditë. Shih F01152/RED.

II. CAKTIMI

3. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësin Kai Ambos

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur për Apelet dhe për çdo çështje që lidhet me to.

_____/nënshkrimi/_____

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Kryetare e Dhomave të Specializuara

E mërkurë, 15 mars 2023

Në Hagë,

Holandë